



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E PROKURORIA E PËRGJITHSHME
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 334 Prot.

Nr. 623 Prot.

Planveprim

**në kuadrin e Nënshkrimit dhe Zbatimit të Marrëveshjes për
bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST**

ndërmjet

**Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionerit për të Drejtën e
Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas nënshkrimit dhe ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligj Nr. 113/2018 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të Republikës së Shqipërisë me EUROJUST dhe në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nënshkruar më 18.05.2012, me anë të këtij planveprimi angazhohen të marrin masat e nevojshme paraprake për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

1. Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale marrin përsipër të krijojnë një grup pune me

përfaqësues të të dy palëve menjëherë pas miratimit të këtij Planveprimi, për marrjen e masave në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST.

2. Nga Prokuroria e Përgjithshme brenda muajit shkurt 2019, do të emërohet *Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale* pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i cili do të shërbejë si pikë kontakti për Zyrën e Komisionerit gjatë këtij procesi dhe në vazhdimësi. Gjithashtu, do të nxitet krijimi i rrjetit të Personave të Kontaktit edhe në Prokuroritë e Rretheve që do të përfshihen në procesin e përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Prokuroria e Përgjithshme me mbështetjen dhe asistencën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do të marrë masat e nevojshme paraprake mbi plotësimin dhe sigurimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

4. Prokuroria e Përgjithshme do të marrë masat e nevojshme për krijimin e një regjistri për komunikimet me EUROJUST, regjistër i cili parashikohet në pikën 9(4) të Marrëveshjes me këtë të fundit. Për marrjen e masave paraprake mbi garantimin e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale në përputhje me standartet e kërkuara nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave, Prokuroria e Përgjithshme do të asistohet nga Zyra e Komisionerit. Krijimi i regjistrit duhet të ketë përfunduar deri në mesin e muajit maj 2019.

5. Për arritjen e këtyre qëllimeve, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, duke filluar nga muaji Mars i vitit 2019 do të organizojë takime vlerësuese dhe konsultuese në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Tiranës, Prokurorinë e Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Shkodrës, Korçës dhe Gjirokastrës, me qëllim njohjen e proceseve përpunuese të të dhënave personale, evidentimin e nivelit të zbatimit të detyrimeve në kuadër të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe evidentimin e mangësive. Këto takime duhet të kenë përfunduar deri në fund të muajit prill 2019.

6. Në vijim të këtyre vizitave dhe konstatimeve, përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit, do të hartojnë një raport lidhur me konstatimet e evidentuara gjatë proceseve

përpunuese të të dhënave personale, në kuadër të të cilit, për organin e Prokurorisë, do të lihen edhe rekomandime sa i përket organizimit të proceseve përpunuese në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe detyrimet e Marrëveshjes me EUROJUST.

7. Raporti i gjetjeve dhe rekomandimet përkatëse sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale do të përcillen nga ana e Komisionerit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive ku do të zhvillohen takimet, deri në fund të javës së parë të muajit maj 2019. Prokuroria e Përgjithshme merr përsipër që këto udhëzime t'i transmetojë në të gjitha Prokuroritë (si pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore ashtu edhe pranë Prokurorive të Apelit) në Republikën e Shqipërisë.

8. Grupi i punës me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do të marrin masa për analizimin e Rregullores së Mbrojtjes së të Dhënave Personale në këtë Prokurori në kuadër të implementimit të detyrimeve specifike që parashikon marrëveshja me EUROJUST, me qëllim parashikimin e shtesave dhe ndryshime të mundshme, nëse do të jetë e nevojshme.

9. Vijimin e bashkëpunimit midis palëve në vazhdimësi, në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të Republikës së Shqipërisë me EUROJUST.

Ky Planveprim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Planveprimi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 kopje origjinale (një prej të cilave depozitohet tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe një në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nënshkruar në Tiranë më, 25 / 02, 2019.

KOMISIONERI

BESNIK DERVISHI



PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

